



Nr. ____ Prot.

Tiranë, më 12.10.2018

UDHËZIM

Nr. 1, Datë 12.10.2018

PËR PROÇEDURËN E APLIKIMIT DHE TE REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TE PARË TË STUDIMEVE NË FAKULTETIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT PËR PERIUdhËN 15 – 20 TETOR 2018 TË KUOTAVE TË PAPLOTËSUARA TË RAUNDIT TË TRETË TË REGJISTRIMEVE PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë”*, si dhe në mbështetje të Udhëzimit të MASR Nr. 18 datë.21.05.2018 *“Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë, në Institucionet e Arsimit të Lartë për vitin akademik 2018-2019”*, kreu IV (Raundi i tretë), pika 2, mbi procedurën e plotësimit të kuotave të paplotësuara në programet e studimit të ciklit të parë ofruar nga FTI për perudhën 15-20 Tetor 2018 të raundit të tretë,

UDHËZOJ:

A. Proçesi i aplikimit

1. Në periudhën 15-18 Tetor 2018, kryhet proçesi i aplikimit të kandidatëve për kuotat e paplotësuara në të treja programet e studimit të ciklit të parë që ofrohen nga FTI. Kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët që nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi, pavarësisht përzgjedhjeve në raundin e parë apo të dytë.
2. Proçesi i aplikimit kryhet nga kandidatët në Protokollin e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit deri në datën 18 Tetor ora 12:00 .
3. Kandidatët që kanë aplikuar më parë në programet e studimit të ciklit të parë në FTI në raundin e parë apo të dytë, mjafton të dorëzojnë personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë nga ana e tyre , dokumentacionin e mëposhtëm:
 - kërkesë me shkrim
 - dokumentin e identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë). Në aplikim mbahet vetëm fotokopja
4. Kandidatët që aplikojnë për herë të parë në programet e studimit të ciklit të parë në FTI, pra që nuk kanë aplikuar në raundin e parë apo të dytë, duhet të dorëzojnë personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë nga ana e tyre , dokumentacionin e mëposhtëm:



- kërkesë me shkrim
 - dokumentin e identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë). Në aplikim mbahet vetëm fotokopja
 - fotokopjen e noterizuar të diplomës së maturës shtetërore ose të dëftesës së pjekurisë, dhe Çertifikatë e maturës shtetërore (ku paraqiten notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme së bashku me provimet e maturës shtetërore)
5. Kandidatët përzgjidhen dhe renditen nga komisionet e vlerësimit dhe të përzgjedhjes të kandidatëve fitues të ngritura në njësitë bazë, sipas formulës së pranimit të miratuar, dhe listat e renditura të fituesve do të shpallen në datën 18 Tetor deri në orën 18.00 në ambjentet e fakultetit dhe në faqen web www.fti.edu.al. Pas fituesit të fundit vendoset vija e kuqe në varësi të kuotave që rezultojnë të paplotësuara pas peridhës së regjistrimit 9-13 Tetor 2018 të raundit të tretë.

B. Procesi i regjistrimit

1. Në periudhën 19-20 Tetor 2018 të gjithë kandidatët që kanë bërë kërkesën dhe janë shpallur fitues në renditjen e shpallur nga Fakulteti mund të kryejnë procesin e regjistrimit me dokumentacionin përkatës pranë sekretarisë mësimore të FTI.
2. Periudha 19-20 Tetor 2018 është e ndarë në 2 faza 24-orëshe. Secili kandidat ndjek ecurinë e procesit të shpalljes fitues të tij në programin e studimit të kërkuar.
3. Kur ai është shpallur fitues, duhet të paraqitet në sekretari brenda afatit 24-orësh. Nëse kandidati nuk regjistrohet brenda afatit 24-orësh, ai humbet të drejtën e regjistrimit në atë program studimi, dhe në rast se pas çdo faze konstatohen kuota të paplotësuara, zhvendoset vija e kuqe dhe shpallen fitues të rinj të asaj faze.
4. Procesi i regjistrimeve kryhet nga sekretaria mësimore në fazat 24-orëshe, sipas listës së fitueve të asaj faze, nga ora 08.00 deri në 16.00 .
5. Nëse pas fazës së fundit 24-orëshe të datës 20 Tetor 2018, konstatohen akoma kuota të paplotësuara, atëherë do të shtohet edhe një fazë tjerët e fundit 24-orëshe regjistrimi, në datën 21 Tetor 2018 në intervalin 08.00 – 16.00, ku do të mund të regjistrohen fituesit e rinj të kësaj faze pas zhvendosjes së vijës së kuqe.

Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi, Komisionet e vlerësimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve fitues të Ciklit të Parë të studimeve në FTI, si dhe Sekretaria Mësimore e FTI-së.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

DEKANI

Prof. Asoc. Vladi KOLIÇI